




NDËRKOMBËTAR
PROGRAMI I KUJDESIT
SHËNDETËSOR

UDHËZUES PËR PUNONJËSIT

Because life matters most.

further®



International
Healthcare
Programme

PËRMBAJTJA

Faqja

Mirësevini në Programin Ndërkombëtar të Kujdesit Shëndetësor	2
• Hyrje	
• Grupi Further	
Çfarë ofron Programi juaj Ndërkombëtar i Kujdesit Shëndetësor	3
• Shërbim për opinion të dytë nga ekspertët mjekësor	
• Precision CancerCare™ - <i>Shërbimi i mjekësisë precize për diagnozën dhe trajtimin e kancerit</i>	
• Trajtimi jashtë vendit	
Si të përdorni International Healthcare Programme	13
• Shërbim për opinion të dytë nga ekspertët mjekësor	
• Precision CancerCare™ - <i>Shërbimi i mjekësisë precize për diagnozën dhe trajtimin e kancerit</i>	
• Trajtimi jashtë vendit	
– Zgjedhja e një spitali ndërkombëtar	
– Përgatitja për trajtim	
– Koha gjatë të cilës merrni trajtim jashtë vendit	
– Shërbimet e ofruara pas kthimit në vendin tuaj të banimit dhe/ose të punësimit	
Skema e përfitimeve	15

Mirësevini në Programin Ndërkombëtar të Kujdesit Shëndetësor

HYRJE

Programi Ndërkombëtar i Kujdesit Shëndetësor është një set unik i përfitimeve shëndetësore të ofruara nga Divizioni Ndërkombëtar i Bankave Filiale të Intesa Sanpaolo (referuar në vijim si: ISP) për të gjithë punonjësit e Grupit, të cilët janë të punësuar me një kontratë pa afat pasi kanë kaluar me sukses periudhën e tyre të provës.

Ju do të keni të drejtë të përfitoni mbulim të sigurimeve gjatë kohës që jeni i punësuar në një nga filialet e Grupit ISP, që merr pjesë në Programin Ndërkombëtar të Kujdesit Shëndetësor, dhe marrëdhënia juaj e punës është aktive.

Programi Ndërkombëtar i Kujdesit Shëndetësor nuk është një program që paguan një shumë të përgjithshme pas përcaktimit të diagnozës, por është një program që mbulon koston e trajtimit në rastet e sëmundjeve të rënda, duke përfshirë organizimet e udhëtimit dhe akomodimit, deri në shumën e siguruar dhe limitet individuale të deklaruar në Skemën e Përfitimeve.

Në këtë udhëzues do të gjeni informacion rreth mundësive që ofron ky program dhe mënyrës së përfitimit të shërbimeve, si dhe një Skemë Përfitimesh të detajuar me shërbimet e disponueshme dhe ato të kufizuara.

Programi Ndërkombëtar i Kujdesit Shëndetësor është një program për mbrojtjen e shëndetit që ju ofron juve dhe, në disa raste, anëtarëve të familjes suaj përfitimet e mëposhtme:

1. **Shërbim për opinion të dytë nga ekspertët mjekësor** i disponueshëm për ju dhe anëtarët e familjes suaj.
2. **Precision CancerCare™** - akses në mjekësi precize për diagnoza të caktuara të kancerit (e disponueshme vetëm për punonjësit, jo për anëtarët e drejtpërdrejtë të familjes, përveç analizës për mutacionet e mundshme të trashëgueshme ashtu siç përshkruhet në faqen 6).
3. **Siguracioni i mbuluar** për trajtimin e sëmundjeve të mbuluara dhe procedurat mjekësore (i disponueshëm vetëm për punonjësit dhe jo për anëtarët e familjes):
 - Mbulim për trajtim mjekësor, shpenzimet për udhëtim dhe akomodim si dhe përfitime të tjera kur merrni trajtim për sëmundje të rënda të caktuara në spitale kryesore ndërkombëtare jashtë vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit, gjithashtu duke përjashtuar çdo institucion mjekësor ose spital që gjendet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës).
 - Rimbursimi i shpenzimeve të medikamenteve pas kthimit në shtëpi.
 - Mbulim të monitorimit dhe survejimit në distancë në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit pas trajtimit jashtë vendit.
 - Orientim dhe mbështetje të plotë gjatë trajtimit jashtë vendit

Ju keni mundësinë që ta blini mbulimin e mësipërm të sigurimit për anëtarët e familjes suaj (bashkëshortin/ën dhe fëmijët në kujdestarinë tuaj). Nëse dëshironi më shumë informacion për t'u siguruar që anëtarët e familjes suaj të kenë akses në trajtimin më të mirë ndërkombëtar, ju lutemi na kontaktoni në ispgeneral@wegofurther.com.

GRUPI FURTHER

Because life matters most.

further.

Shërbimet e përfshira në këtë Program ofrohen nga Grupi Further.

Further është i specializuar për rastet dhe sëmundjet e rënda mjekësore. Ai përshpejton aksesin tek trajtimet dhe teknologjitë më të fundit, me ekspertizën mjekësore ndërkombëtare më të mirë dhe ofron mbështetje dhe udhëzim gjatë gjithë periudhës së trajtimit. Pavarësisht vendbanimit tuaj, Grupi Further ju siguron akses në spitalet dhe trajtimet më të mira në mbarë botën. Stafi i Grupit Further është në dispozicionin tuaj për t'ju ndihmuar të vendosni se ku dhe kush do t'ju trajtojë, bazuar në gjendjen dhe preferencat tuaja specifike. Grupi Further ofron zgjidhje duke u kujdesur për të gjitha marrëveshjet dhe pagesat, në mënyrë që ju të përqendrohemi në shëndetin dhe rikuperimin tuaj.

Çfarë ofron Programi juaj Ndërkombëtar i Kujdesit Shëndetësor

SHËRBIM PËR OPINION TË DYTË NGA EKSPERTËT MJEKËSOR

Ju mund të përfitoni një shërbim për opinion të dytë mjekësor, i cili ju ofron këshilla dhe informacione nga specialistë të njohur ndërkombëtarë.

Shërbimi është i disponueshëm për ju si punonjës i siguruar nga Programi, për bashkëshortin/en dhe fëmijët tuaj nën moshën 18 vjeç ose nën moshën 25 vjeç nëse vazhdojnë arsimin me kohë të plotë. Ky shërbim ofron rishikimin e çdo gjendjeje mjekësore që konsiderohet të jetë kritike, kronike ose degjenerative, si dhe ato që ndikojnë në aftësinë e një individi për të vazhduar kryerjen e aktiviteteve të tyre normale të përditshme.

Elementi kryesor i shërbimit është një bazë të dhënash nga ekspertët me mbi 53.000 specialistë të njohur në botë, e cila përdor një metodologji të emëruar nga kolegët për të ndërtuar një rrjet të respektuar dhe unik specialistësh të cilët janë të njohur ndërkombëtarisht si më të mirët në fushën e tyre.

Si pjesë e këtij shërbimi, ne do të mbledhim të dhënat tuaja mjekësore dhe testet diagnostikuese dhe do t'i dërgojmë ato tek specialisti i zgjedhur për shqyrtim gjithëpërfshirës. Specialisti i përzgjedhur do t'ju sigurojë juve ose anëtarëve të familjes suaj një raport të qartë dhe të specializuar që shqyrton dhe konfirmon si diagnozën ashtu edhe planin e trajtimit. Gjatë gjithë procesit ju ose anëtari juaj i familjes do të ndihmoheni nga një menaxher i përkushtuar i rastit. Ky shërbim mund të kërkohej në çdo kohë.

Shënim: Shërbimi nuk është i disponueshëm në lidhje me rastet psikiatrike, rastet akute (ku simptomat shfaqen dhe ndryshojnë ose përkeqësohen me shpejtësi), sëmundjet e vogla kronike, problemet dentare ose në rast se ju ose anëtari i familjes suaj jeni shtruar në spital në kohën që bëni kërkesën.

PRECISION CANCERCARE™

Shërbimi i mjekësisë precize për diagnozën dhe trajtimin e kancerit

Mjekësia precize, një shërbim në vijën e parë të avancimeve mjekësore në luftën kundër kancerit, mjekësia precize, u ofron individëve të diagnostikuar me lloje të caktuara të kancerit, mundësinë për të pasur një mostër biopsie të analizuar nga laboratorët më të avancuar, duke përdorur teknika të profilizimit molekular siç është Sekuenca e Gjeneratës së Ardhshme. Rezultatet shpjegohen nga Bordi i Ekspertëve Mjekësor, i përbërë nga gjenetistë dhe onkologë të njohur, në një plan trajtimi të personalizuar (të synuar), me rekomandime specifike për trajtimin në përputhje me profilin unik gjenetik të kancerit të secilit individ. Nëse analiza e profilizimit molekular zbulon një mutacion të trashëgueshëm që mund të kalojë tek anëtarët e familjes, anëtarët e drejtpërdrejtë të familjes gjithashtu do të testohen dhe, nëse ata rezultojnë pozitivë, mund të caktohet një seancë me një konsulent gjenetik.

Precision CancerCare™ mund të aplikohet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

1. Ju jeni aktualisht duke marrë trajtim për kancerin ose keni marrë një rekomandim me shkrim për trajtim të menjëhershëm të kancerit; dhe
2. Diagnoza juaj e kancerit klasifikohet sipas njërit prej kriterëve të mëposhtme:
 - kanceri nuk i përgjigjet trajtimit të linjës së parë (siç është konfirmuar nga mjeku onkolog);
 - kanceri është diagnostikuar në Fazën III ose IV;
 - kanceri ka origjinë primare të panjohur (mungesa e një tumori primar qartësisht të zbulueshëm);
 - forma të rralla të kancerit*; dhe
3. Materiali i duhur për analizën është i disponueshëm në formën e një mostre biopsie me një numër të mjaftueshëm të qelizave tumorale. Kur mostra nuk përmban një numër të mjaftueshëm të qelizave tumorale, mund të kryhet një biopsi e lëngshme (mostra e gjakut), nëse kjo është e përshtatshme nga aspekti klinik.

Ky shërbim përfshin:

- Grumbullimin e të dhënave mjekësore përkatëse.
- Organizimin për sigurimin e mostrës së analizës dhe dërgimin e mostrës tek partneri i zgjedhur laboratorik.
- Analizën e profilizimit molekular të kryer nga laboratorë të specializuar duke përfshirë një kontroll teknik dhe raport mbi profilin molekular të kancerit të individit.
- Një Bord Ekspertësh Mjekësor rishikojë këto rezultate dhe do të përkthejë të dhënat në rezultate klinike të zbatueshme, të cilat do të ndahen me ju nëpërmjet Raportit Klinik të Ekspertëve, të përkthyer plotësisht në gjuhën tuaj amtare.
- Mbështetje & udhëzim për ju dhe onkologun tuaj të trajtimit për të shpjeguar rezultatet dhe të dhënat e raportit.
- Në rast kur zbulohet një kancer i trashëgueshëm, shërbimi zgjerohet për të përfshirë një analizë gjenetike për mutacionet e geneve të kancerit të trashëgueshëm për anëtarët e familjes.
- Nëse trajtimi më i mirë i rekomanduar nuk ofrohet në nivel lokal, ose dëshironi të kërkonit trajtim në një qendër ekselence jashtë vendit, do të organizohet trajtimi përfundimtar jashtë shtetit në qendrat e njohura të trajtimit të kancerit në botë, duke përfshirë të gjitha organizimet e udhëtimit dhe kostot për ju dhe shoqëruesin tuaj.
- Nëse në Raportin Klinik të Ekspertëve këshillohet të shqyrtohet mundësia e aksesit në një trajtim specifik përmes një prove klinike, atëherë do të ofrohet udhëzimi dhe mbështetja e plotë.

* Kancer me një incidencë prej <6/100.000 përfshihen në Mbikëqyrjen e Kancerit të Rrallë në Evropë (RARECAR).
Shihni listën e përditësuar të publikuar në faqen e tyre të internetit www.rarecare.eu

Cilat janë rezultatet e mundshme të analizës së mjekësisë precize?

Një pacient me kancer i cili ka bërë sekuençën e tumorit mund të marrë ndonjë nga rekomandimet e mëposhtme nga Raporti Klinik i Ekspertëve në varësi të profilin molekular të kancerit të tyre:

Rezultati 1 Terapitë e zakonshme: Trajtimet standarde me kimioterapi ose radioterapi.

Rezultati 2 Terapitë e reja (të aprovuara dhe jo të aprovuara): Terapitë e synuara, terapitë imunitare, terapitë hormonale, trajtimi CAR-T.

Rezultati i 3 Provat klinike: Terapitë që nuk janë miratuar ende si trajtime standarde dhe aktualisht janë në Provë Klinike. Provat klinike mund të zhvillohen në vendin tuaj (brenda shtetit) ose jashtë vendit (jashtë shtetit).

3A - Brenda vendit

Nëse regjistrohesh në një provë klinike të organizuar në një spital ose institucion mjekësor në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit, dhe jashtë një rreze prej 70 km nga vendi i banimit dhe/ose punësimit, do të mbulohen shpenzimet për udhëtimin, akomodimin dhe riatdhesimin.

Për më tepër, ju do të merrni një kompensim ditor prej 100 eurosh për çdo ditë që ju merrni medikamentin që po hulumtohet ose testohet si pjesë e protokollit të provës klinike.

Pagesa e kompensimit ditor është e kufizuar në një maksimum prej 60 ditësh.

3B - Jashtë vendit

Nëse regjistrohesh në një Studim Klinik që organizohet në një spital ose institucion tjetër mjekësor jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe vendit të banimit dhe/ose punësimit, do të mbulohen shpenzimet mjekësore(*), shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe riatdhesimit.

Për më tepër, ju do të merrni një kompensim ditor prej 100 eurosh për çdo ditë që ju merrni medikamentin që po hulumtohet ose testohet si pjesë e protokollit të provës klinike.

Pagesa e kompensimit ditor është e kufizuar në një maksimum prej 60 ditësh.



Çfarë janë medikamentet jo të aprovuara?

Medikamentet „jo të aprovuara“ nënkuptojnë barnat që përdoren për sëmundjet ose gjendjet për të cilat nuk është dhënë miratimi për t'i trajtuar. Kjo mund të nënkuptojë që ilaçi është:

- Aprovuar për të trajtuar një lloj kanceri, por një mjek e përdor atë për të trajtuar një lloj tjetër kanceri.
- Jepet në një dozë të ndryshme.

Jepet në një mënyrë tjetër nga ajo që është miratuar, si psh: një ilaç aprovohet si kapsulë, por në vend të saj ai jepet në një

Çfarë është një provë klinike?

Provat klinike janë studime kërkimore që kryhen tek pacientët dhe kanë për qëllim gjetjen e mënyrave të reja për të përmirësuar trajtimet dhe cilësinë e jetës. Provat klinike janë hapi i fundit i një procesi të gjatë që fillon me një kërkim të kujdesshëm në një laborator. Nëpërmjet provave klinike, mjekët përcaktojnë nëse trajtimet e reja janë të sigurta dhe efektive dhe funksionojnë më mirë se trajtimet aktuale standarde të kujdesit. Provat klinike mund t'u sigurojnë pacientëve akses në barna të reja që nuk janë ende të disponueshme në klinikë.

(*) Organizatori i Provës Klinike normalisht financon administrimin e ilaçeve nën hetim dhe testimin në vazhdim të rezultateve të provës në gjendjen shëndetësore të pjesëmarrësve. Provat klinike në përgjithësi kryhen paralelisht ose në kombinim me trajtimin aktual të pranuar për diagnozën e kancerit ose qasjen e duhur "Të aprovuar" të cituar në këtë dokument në vijim si "Standardi i Kujdesit". Sipas skenarit B, Programi do të mbulojë koston e Standardit të Kujdesit.

Çfarë nuk përfshihet në **Precision CancerCare™**?

- Kostoja e kryerjes së biopsive, me përjashtim të marrjes së gjakut për një biopsi të lëngshme.
- Për rezultatet mjekësore 1 & 2: Politika nuk do të mbulojë asnjë kosto të protokollit për trajtimin mjekësor të kryer në vendin e banimit dhe/ose punësimit.
- Për rezultatit mjekësor 2: Politika nuk do të mbulojë asnjë kosto të protokollit për trajtimin mjekësor “Jo të aprovuar” të kryer që nuk është rekomanduar në Raportin Klinik të Ekspertëve.
- Për rezultatit mjekësor 3A: Çdo shpenzim mjekësor i shkaktuar për Standardin paralel të Kujdesit gjatë marrjes së kujdesit mjekësor në kuadër të një prove klinike ose që nuk është financuar nga organizatori i provës klinike.
- Për rezultatit mjekësor 3B: Çdo shpenzim mjekësor në lidhje me Standardin e Kujdesit që jepet në një spital ose institucion mjekësor të ndryshëm nga ai ku po zhvillohet Prova Klinike dhe miratohet nga Further.
- Trajtimi për çdo efekt anësor të padëshiruar ose komplikime mjekësore të shkaktuara nga Prova Klinike.
- Çdo shpenzim që lidhet me udhëtimet ose akomodimet të shkaktuar nga ju dhe/ose anëtarët e familjes suaj si rezultat i pjesëmarrjes në takimet e planifikuara për sigurimin ose marrjen e mostrës së analizës.
- Çdo tarifë administrative ose kosto tjetër (nëse është e aplikueshme) për regjistrimin në Provën Klinike.

TRAJTIMI JASHTË VENDIT

Ju mund të vendosni të kërkonti trajtim mjekësor jashtë vendit tuaj të banimit dhe/ose të punësimit në lidhje me sa më poshtë:

Trajtimi i kancerit

Trajtimi i:

- Çdo tumori malinj duke përfshirë leuçeminë, sarkomën dhe limfomën (përveç limfomës kutane), të karakterizuara nga rritja dhe përhapja e pakontrolluar e qelizave malinje dhe pushtimi i indeve;
- Çdo kancer në vendin origjinal i cili është i kufizuar në epitelin nga e ka origjinën dhe nuk ka depërtuar në stromën ose indet përreth;
- Çdo ndryshim kanceröz paraprak në qelizat që klasifikohen citologjikisht ose histologjikisht si displazia e shkallës së lartë ose displazia e rëndë.

Kirurgjia by-pass e arterieve koronare

Kryerja e kirurgjisë me rekomandimin e një kardiologu konsulent për të korrigjuar ngushtimin ose bllokimin e një ose më shumë arterieve koronare me grafte by-pass.

Zëvendësimi ose riparimi i valvulës së zemrës

Ndërhyrja kirurgjikale kryhet me rekomandimin e një kardiologu konsulent për të zëvendësuar ose riparuar një ose më shumë valvula të zemrës.

Neurokirurgjia

Nënkupton:

- Çdo ndërhyrje kirurgjikale e trurit ose e ndonjë strukture tjetër intracraniale;
- Trajtimi i tumoreve beninje të vendosura në palcën kurrizore.

Transplantimi i organeve me dhurues të drejtpërdrejtë

Nënkupton një transplant kirurgjik në të cilin personi i siguruar merr një veshkë, një segment të mëlçisë, një lob pulmonar ose një seksion të pankreasit nga një dhurues i përputhshëm në jetë.

Transplantimi i palcës së kockave

Nënkupton Transplantimi i Palcës së Kockave (BMT) ose Transplantimi i Qelizave Staminale të Gjakut Periferik (PBSCT) të qelizave të palcës së kockave tek personi i siguruar me origjinë nga:

- Vetja (transplant autolog i palcës së kockave); ose
- Nga një dhurues i përputhshëm në jetë (transplantim alogjenik i palcës së kockave).

Ky program do të paguajë për:

- Shpenzimet dhe shërbimet e shtrimit në spital, duke përfshirë kirurgjinë, vizitat ose konsultimet e mjekëve, analizat dhe testet mjekësore, transfuzionet, ilaçet (duke përfshirë deri në 30 ditë pas largimit nga spitali jashtë vendit dhe blerjen e tyre pas kthimit në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit), transferimet ose ambulancat ajrore nëse është e nevojshme nga ana mjekësore;
- Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për personin e siguruar së bashku me një shoqërues dhe dhurues (në rast transplantit);
- Shpenzimet e riatdhesimit për personin e siguruar dhe dhuruesin (në rast transplantit) në rast vdekjeje gjatë trajtimit jashtë vendit;
- Koston e medikamenteve (Përfitimi i Medikamenteve) për vazhdimin e trajtimit gjatë kthimit në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit.
- Kujdesi vijues: kostoja e monitorimit dhe mbikëqyrjes pas kthimit në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit.

Ky program nuk do të paguajë për:

- Çdo trajtim ose shpenzim mjekësor brenda vendit të banimit dhe/ose punësimit (me përjashtim të Përfitimit Mjekësor dhe Përfitimit të Kujdesit Vijues)
- Rimbursimi për medikamentet që nuk janë miratuar paraprakisht nga Kompania e Sigurimeve dhe nga Grupi Further;
- Trajtimi ose shpenzimet mjekësore të rregulluara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Ju lutemi kontaktoni me Burimet Njerëzore për më shumë informacion mbi kushtet/trajtimet/shpenzimet e mbuluara dhe të pambuluara.

Përfitimet që mundëson Programi Ndërkombëtar i Kujdesit Shëndetësor

SHËRBIM PËR NJË OPINION TË DYTË NGA EKSPERTËT MJEKËSOR

Për të kërkuar një opinion të dytë mjekësor sipas Programit, ju ose anëtar i familjes duhet të [telefononi gendrën e shërbimit ndaj klientit](#) ose të dërgoni email në ispclaim@wegofurther.com. Pasi ju ose anëtar i familjes të jeni vënë në kontakt dhe kërkesa për shërbimin e Opinionit të Dytë Mjekësor të jetë miratuar, ju ose anëtar i familjes do të merrni një paketë informacioni. Kjo paketë informacioni do të shpjegojë në detaje se çfarë përfshin ky shërbim dhe cilat seksione ju ose anëtar i familjes suaj do të duhet të plotësoni (duke përfshirë nënshkrimin e formularëve të duhur të autorizimit dhe pëlqimet e privatësisë). Menaxheri i dedikuar i rastit do t'ju ndihmojë ju ose anëtarin e familjes suaj dhe kërkesa do të trajtohet në mënyrë konfidenciale.

Informacioni që ju ose anëtar i familjes suaj do t'ju kërkohet të jepni do të përfshijë emrat e spitaleve dhe mjekëve që keni vizituar, informacionin për gjendjen tuaj mjekësore, si dhe historikun tuaj mjekësor. Procesi i Opinionit të Dytë Mjekësor fillon me Marrjen Mjekësore, ky është hapi ku ju ose anëtarit të familjes suaj do t'ju bëhen disa pyetje themelore dhe të nevojshme shëndetësore.

Ju ose anëtar i familjes suaj do të duhet gjithashtu të mundësoni një deklaratë pëlqimi të nënshkruar (në disa raste do të kërkohet një prokurë) në mënyrë që të dhënat tuaja mjekësore mund të kërkohen dhe të përdoren nga mjeku juaj i trajtimit ose nga ofrues të tjerë të shërbimit mjekësor. Si opsion, ju ose anëtar i familjes suaj mund të jepni dokumentacion mjekësor direkt.

Në mënyrë të përmbledhur, shërbimi i Mendimit të Dytë Mjekësor do të kërkojë

- Kërkesën e nënshkruar nga ju ose nga përfaqësuesi juaj ligjor për miratimin e publikimit të të dhënave mjekësore nga mjekët që trajtojnë rastin;
- Një kopje e një dokumenti identifikimi. Dokumentet e pranura përfshijnë:
 - Pasaportë / letërnjoftim lokal
 - Certifikatë lindje
- Të dhënat/historiku mjekësor përkatës të sëmundjes që po shqyrtohet së bashku me një deklaratë mjekësore të lëshuar nga zyra përkatëse mjekësore me diagnozën përfundimtare dhe përshkrimin e trajtimit të kryer (nëse ka);
- Të gjitha kopjet përkatëse të rezultateve të analizave laboratorike, klinike, historike dhe të tjera të certifikuara nga zyra mjekësore lëshuese. Në përgjithësi materialet mjekësore bazë që do të kërkohen janë si më poshtë:
 1. Kopje të letrave të korrespondencës mjekësore nga mjeku i trajtimit të rastit (që mund të jetë një mjek i përgjithshëm ose një specialist).
 2. Kopje të rezultateve të fundit laboratorike.
 3. Kopje të raporteve të patologjisë / kirurgjisë (nëse ka të bëjë).
 4. Kopje të raporteve të radiologjisë (nëse ju/ata keni bërë studime imazherike).
 5. Kopje të grafive (nëse ju/ata keni bërë studime imazherike).

Dokumentacioni shtesë nga pikëpamja mjekësore mund të kërkohe sipas rastit.

Pasi të jenë marrë të dhënat tuaja mjekësore ose të anëtarit të familjes suaj, rasti do t'i referohet një eksperti ndërkombëtar të përzgjedhur si „më i miri“ nga mjekët e tjerë për të adresuar pyetjet tuaja ose të anëtarit të familjes suaj. Eksperti ndërkombëtar do të sigurojë një raport të kualifikuar që do të përmbajë një vlerësim të diagnozës suaj ose të anëtarit të familjes suaj dhe përgjigje të pyetjeve. Ky raport do të dorëzohet një përkthim në gjuhën amëtare.

Në varësi të rrethanave mjekësore të rastit, ndihma mund të jepet në dorëzimin e raportit tek mjeku juaj ose mjeku i anëtarit të familjes suaj në mënyrë që gjetjet e raportit të ekspertit të mund të merren në konsideratë në planin e mëposhtëm të trajtimit.

Raporti i Opinioni të Dytë Mjekësor normalisht do të jetë në dispozicion 2-3 javë pas marrjes së të gjithë dokumentacionit mjekësor të kërkuar, me kohën e përgjigjes në varësi të kompleksitetit të rastit, sasisë së materialit diagnostikues dhe numrit të ekspertëve të përfshirë në përgatitjen e tij.

PRECISION CANCERCARE™

Shërbimi i mjekësisë precize për diagnozën dhe trajtimin e kancerit

(opsion i disponueshëm vetëm për punonjësit e përfshirë në program dhe duke përjashtuar

anëtarët e familjes përveç testimit për mutacionet e trashëguara).

Ju mund të paraqisni një kërkesë për shërbimin Precision CancerCare™ përmes adresës së dedikuar të emailit ISP në Further - ispclaim@wegofurther.com, dhe ekipi i Precision CancerCare™ në Further do të iniciojë shërbimin duke siguruar një lidhje ku mund të ngarkohet informacioni mjekësor.

Ekipi ynë në Further do t'ju mbështesë gjatë gjithë procesit dhe do t'ju udhëzojë përmes dokumentacionit të kërkuar, vlefshmërisë, analizës dhe rezultateve.

TRAJTIMI JASHTË VENDIT (siguracioni i mbuluar)

(Opsion është i disponueshëm vetëm për punonjësit e përfshirë në Program duke përjashtuar

anëtarët e familjes)

Nëse kërkesa juaj është të kërkonti trajtim jashtë vendit për një sëmundje ose procedurë mjekësore të mbuluar, do t'ju kërkohe të ndiqni të njëjtën procedurë siç shpjegohet më sipër kur kërkonti një opinion të dytë mjekësor.

Nuk është e nevojshme që të plotësohet Opinioni i Dytë Mjekësor nëse konsiderohet trajtimi jashtë vendit në rast se:

- gjatë shqyrtimit të parë të rastit, Further bie dakord se është bërë një vlerësim i saktë i nevojave mjekësore siç duhet, ose
- gjendja kërkon kujdes urgjent mjekësor.

Megjithatë, ju lutemi kini parasysh se kartela mjekësore duhet t'i dorëzohet Further për të vlerësuar rastin dhe për të konfirmuar që kërkesa juaj është e pranueshme.

Nëse kërkesa juaj është e vlefshme dhe kushti mbulohet nga Programi, Further do t'ju kërkojë të konfirmoni nëse dëshironi të konsideroni mundësinë e marrjes së trajtimit jashtë vendit.

Opsionet e klinikave jashtë vendit

Further do t'ju ofrojë një listë të spitaleve kryesore ndërkombëtare nëse zgjidhni të merrni trajtim jashtë vendit. Në përgjithësi lista përmban të paktën tre spitale, por në varësi të natyrës mjekësore të rastit, mund të rekomandohet në mënyrë më specifike një spital i veçantë.

Më pas do t'ju kërkohe të konfirmoni zgjedhjen tuaj për njërin nga këto spitale brenda tre muajve në vijim. Kjo bëhet nëpërmjet formularit përkatës që Further ju vë në dispozicion. Ju gjithashtu duhet të përmendni se kush do të jetë shoqëruesi juaj. Nëse Further nuk merr një përgjigje brenda këtyre tre muajve, mund të jetë e nevojshme të rivlerësojë situatën e gjendjes suaj mjekësore dhe t'ju paraqesë një listë të përditësuar të spitaleve.

Ka disa elementë në lidhje me marrjen e trajtimit jashtë vendit që duhet të keni parasysh:

- Ndikimi financiar i marrjes së trajtimit jashtë vendit, bazuar në koston e jetesës në vendin e destinacionit;
- Koston e shpenzimeve që nuk mbulohen nga ky Program (për shembull, shpenzimet për ushqim gjatë trajtimit ambulator, përveç mëngjesit, për ju dhe për shoqëruesin tuaj) - disa nga shpenzimet që nuk mbulohen mund të paguhen duke përdorur përfitimin e dëmshpërblimit ditor të shtrimit në spital që Programi mund të ofrojë;
- Kohëzgjatjen e parashikuar të trajtimit;
- Aspektet psikologjike të të qenit larg shtëpisë ose anëtarëve të familjes suaj dhe dallimet kulturore dhe gjuhësore me vendin tuaj të origjinës ose vendin e banimit;
- Ju duhet të keni një pasaportë të vlefshme dhe të jeni në gjendje të merrni një vizë për vendin e destinacionit që është marrë në konsideratë.

Further do t'ju ofrojë mbështetje dhe ndihmë gjatë gjithë procesit të aplikimit për vizë, duke përfshirë sigurimin e të gjithë dokumentacionit mjekësor përkatës që nevojitet për aplikim dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm mbështetës.

Gjithashtu, do të dorëzojë aplikimin për vizë në emrin tuaj dhe do të ndjekë ecurinë aty ku është e mundur.

Programi do të paguajë shpenzimet administrative të krijuara si rezultat i procesit të aplikimit për vizë. Megjithatë, Further nuk ju garanton që aplikimi për vizë do të jetë i suksesshëm.

Nëse është e nevojshme, ne do të ofrojmë mbështetje për procesin e aplikimit për vizë, si dhe për çdo shërbim tjetër ndihme që kërkohet, siç është caktimi i takimeve në konsullatën ose ambasadën përkatëse.

Përgatitja për trajtim

Pasi Further të ketë marrë konfirmimin tuaj për zgjedhjen e spitalit, do të caktohen datat për udhëtimin dhe shtrimin në spital dhe do të pajiseni me një Certifikatë Mjekësore Paraprake.

Certifikata Paraprake Mjekësore është miratimi me shkrim i kërkesës së ofruar nga Further. Kjo Certifikatë përfshin konfirmimin e mbulimit sipas këtij Programi përpara se shërbimet të kryhen në spitalin e përcaktuar, për çdo trajtim, shërbim, furnizim ose recetë në lidhje me kërkesën.

Këshillohet që të blini sigurim udhëtimi për të mbuluar rrethanat e paparashikuara që nuk mbulohen nga ky program.

Organizimet për shtrimin në spital:

- Further do të vendosë në dispozicion të personelit mjekësor në spital kartelën tuaj mjekësore;
- Further do të organizojë shoqërimin në udhëtimin e parë në spital ose tek mjeku trajtues dhe do të ndihmojë në lidhje me dokumentat dhe organizimin e shtrimit në spital;
- Further do të paguajë koston e trajtimit mjekësor të mbuluar nga Programi direkt në spital.

Organizimet për udhëtimin::

- Further do të organizojë dhe do të paguajë për transportin nga adresa juaj e përhershme për ju dhe shoqëruesin tuaj të udhëtimit (duke përfshirë dhuruesin në rast transplantit) në aeroportin e caktuar ose në stacionin hekurudhor ndërkombëtar, biletën hekurudhore të klasës ekonomike ose biletën ajrore për në qytetin e destinacionit të trajtimit dhe transportin deri në hotelin e caktuar;
- Further do t'ju vijë në ndihmë për të njëjtat organizime gjatë udhëtimit të kthimit për ju ose anëtarin e familjes suaj pas përfundimit të trajtimit jashtë vendit.

Organizimet për akomodimin:

- Further do të organizojë dhe do të paguajë për akomodimin tuaj dhe atë të shoqëruesve tuaj (duke përfshirë dhuruesin në rastin e transplantit) gjatë qëndrimit jashtë vendit me qëllim marrjen e trajtimit;
- Marrëveshja e akomodimit përfshin rezervime për një dhomë gjumi me krevat dopio ose dhomë gjumi me dy krevate në hotele 3 ose 4 yje (sipas standardeve ndërkombëtare);
- Zgjedhja e hotelit do të bëhet në varësi të disponueshmërisë dhe afërsisë me spitalin ose mjekun trajtues brenda një rreze prej 10 kilometrash;
- Mëngjesi do të jetë i përfshirë me akomodimin në hotel.

Meqenëse Further mbulon mëngjesin në hotel, do t'ju duhet të merrni përsipër shpenzimet e tjera, si p.sh. vaktet e tjera ose përdorimi i lavanderisë.

Further do të bëjë një vlerësim të arsyeshëm të kohëzgjatjes së trajtimit bazuar në përvojën e rasteve të ngjashme dhe si rrjedhojë do të organizojë akomodimin. Këto do të rregullohen nëse është e nevojshme, sipas ecures të trajtimit.

Gjatë kohës së trajtimit tuaj jashtë vendit

Gjatë kohës që merrni trajtim jashtë vendit, do të vazhdoni të jeni në komunikim të drejtpërdrejtë me Further përmes Menaxherit të Rastit.

Ju mund të kontaktoni Further nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me ecurinë e trajtimit ose ndonjë pyetje tjetër në lidhje me kërkesën. Further do të ofrojë shërbime përkthimi mjekësor gjatë kohës që jeni shtruar në spital ose nën kujdesin e një profesionisti mjekësor jashtë vendit sipas nevojës.

Pas kthimit në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit

Pas kthimit, Further do të sigurojë që ju të keni një raport gjithëpërfshirës lidhur me trajtimin jashtë vendit dhe një plan të përshkruar për vazhdimin e trajtimit në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit. Further do t'i përkthejë këto për ju dhe do të diskutojë çdo hap gjatë kujdesit në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit.

Shpenzimet mjekësore

Pas trajtimit jashtë vendit, Further do të propozojë një plan për medikamentet për vazhdimin e trajtimit. Ekziston një Përfitim Medikamentesh në këtë program i projektuar posaçërisht për të mbuluar shpenzimet për ilaçet e blera. Që ky përfitim të jetë i pagueshëm sipas Programit ju duhet të merrni receta për mjekim nga mjekët që ju ndjekin në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit.

Further do të diskutojë detajet e Përfitimit të Medikamenteve me ju para kthimit tuaj në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit, në mënyrë që të jeni në dijeni se cilat medikamente saktësisht mbulohen dhe nuk mbulohen.

Pasi të keni filluar Përfitimin e Medikamenteve pas kthimit në vendin tuaj të banimit dhe/ose punësimit, ju do të rimbursoheni për shpenzimet e bëra sipas këtij plani.

Further do t'ju ofrojë një formular rimbursimi që do të dorëzohet nga ju me faturat përkatëse dhe recetat e ilaçeve të blera. Më pas, Further do të rimbursojë direkt në llogarinë tuaj bankare shumën e caktuar brenda 10 ditëve punë.

Kujdesi vijues

Pasi ktheheni në shtëpi pas trajtimit jashtë vendit, ky Program do të mbulojë kostot e kujdesit vijues në vendin tuaj të lindjes, për sa kohë që përmbushen këto kushte:

- Zgjedhja e spitalit: duhet të merrni kujdesin vijues në një prej spitaleve të zgjedhura nga Further.
- Disponueshmëria lokale: kujdesi i nevojshëm vijues duhet të jetë i disponueshëm në vendin tuaj të lindjes, si për sa i përket koordinimit ashtu edhe llojit të kujdesit që nevojitet.
- Rekomandimet e mjekut: kujdesi juaj vijues duhet të ndjekë rekomandimet e mjekëve ndërkombëtarë që ju kanë trajtuar.
- Periudha e mbulimit: kujdesi vijues duhet të kryhet brenda periudhës së mbulimit të policës.

Si funksionon:

1. Vetëpagesa: do t'ju duhet të jepni paradhënie për kujdesin vijues.
2. Rimbursimi: Further do t'ju rimbursojë për kostot pas marrjes së faturës origjinale dhe vërtetimit të pagesës. Dokumentacioni duhet të paraqitet brenda 180 ditëve.

Ndryshimet në protokoll:

Nëse mjekët në vnedin tuaj sugjerojnë një protokoll tjetër të kujdesit vijues ndryshe nga ai që ju kanë rekomanduar fillimisht mjekët ndërkombëtarë, Further do të koordinohet fillimisht me mjekët ndërkombëtarë për të marrë miratimin e tyre. Pas miratimit, ne do t'ju rimbursojmë për çdo kosto që ka ardhur si rezultat i zbatimit të protokollit të ri të kujdesit vijues.

Kostot e përbashkëta:

Nëse sistemi shëndetësor publik i vendit tuaj ose polica të tjera sigurimi mbulojnë një pjesë të kostove të kujdesit vijues, Further do t'ju rimbursojë vetëm për pjesën që ju nxirrni nga xhepi juaj. Ndani në mënyrë të qartë këto kosto në kërkesën tuaj të rimbursimit.

Skema e përfitimeve

Limiti i shumës së siguruar për Person të Siguruar/Policë vjetor	500.000 Euro
Limiti Total gjatë jetës për Person të Siguruar	1.000.000 Euro
Trajtimi mjekësor jashtë shtetit	Mbulohet deri në shumën e siguruar
Udhëtimi dhe akomodimi	Shpenzimet përfshihen brenda limiteve të shumës totale të siguruar vjetore dhe gjatë jetës
Dëmshpërblimi ditor për shtrimin në spital gjatë trajtimit jashtë vendit	100 Euro në ditë e kufizuar në 60 ditë për kërkesë për dëmshpërblim
Shpenzimet e medikamenteve pas kthimit	50.000 Euro gjatë kohëzgjatjes së Policës së sigurimit
Kujdesi vijues pas kthimit	Mbulohet deri në shumën e siguruar
Analiza Precision CancerCare	Një analizë e profilizimit molekular dhe rishikimi përkatës (një Raport Klinik i Ekspertëve) për çdo diagnozë unike të kancerit
Trajtimi jashtë vendit i rekomanduar nga Raporti Klinik i Ekspertëve	Mbulohet deri në shumën e siguruar
Udhëzimi për Provën Klinike	Udhëzimi i Provave Klinike ofrohet një herë për çdo kërkesë të përshtatshme të shërbimit të Mjekësisë Precize, plus një kërkim të dytë dhe të fundit kur kërkitimi i parë nuk çon në regjistrimin e të Siguruarit në një Provë Klinike
Kryerja e analizave të anëtarëve të familjes për mutacione të trashëgueshme	Një analizë gjenetike lidhur me mutacionet e gjeneve të kancerit të trashëgueshëm për çdo anëtar të familjes, duke përfshirë seancë me një Konsulent Gjenetik
Pagesa e kompensimit ditor gjatë Studimit Klinik.	100 EUR në ditë e kufizuar në 60 ditë
Shërbim për Opinion të Dytë Mjekësor për ju dhe për anëtarët e familjes suaj	E pakufizuar

PROGRAMI NDËRKOMBËTAR I KUJDESIT
SHËNDETËSOR

Për çdo pyetje, ju lutemi na kontaktoni në:

ispgeneral@wegofurther.com

ose vizitoni

internationalhealthcareprogramme.com/contact-us

Because life matters most.
further



**International
Healthcare
Programme**

Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë

Përmbajtja e këtij dokumenti është vetëm për qëllime informacioni. Termat dhe kushtet aktuale të mbulimit përfshihen në Policën Kryesore të nënshkruar midis klientit dhe Siguruesit.